

13/01/2021

## STATUTI I SHOQËRISË "ORGANIMIC" shpk

### KRIJIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI

#### NENI 1

Shoqëria "ORGANIMIC" Sh.p.k., me seli në Vila 21, Rruga Prokop Myzeqari, Tiranë, Shqipëri, është krijuar Ortakja e Vetme e saj znj. SHEYDA PEYMAN e datëlindjes 14/04/1992, me numër pasaporte Gjermane C4X6TV6Y6, banuese në Tiranë.

#### NENI 2

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregëtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, të Ligjit nr.7638 dt.19.11.1999 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 "Për regjistrimin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare", si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Shoqëria ka vulën dhe emrin e saj.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e përpunimit të tokës, bujqësisë, blegtorisë, hotelerisë, turizmit dhe agro-turizmit, përpunimit dhe shit-blerjes së produkteve ushqimore, ndërtimit të ndërtesave në shërbim të të mësipërmeve si dhe punës kërkimore dhe konsulencës në këto fusha dhe të ngjashme.

#### NENI 3

Emërtimi i Shoqërisë është "ORGANIMIC" Sh.p.k.

#### NENI 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.


#### NENI 5

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Vila 21, Rruga Prokop Myzeqari, Tiranë, Shqipëri

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është [organimic.com](http://organimic.com)

Adresat e kontaktit: email: [info@organimic.com](mailto:info@organimic.com) , tel. 067 269 2699

### KAPITALI THEMELTAR



**NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë, e ndarë në një kuotë të vetme, ndërmjet Ortakut të vetëm të shoqërisë.

**NENI 7**

Me vendim të ortakut, kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para ose në natyrë. Po kështu mund të zvogëlohet kur kjo gjë motivohet nga humbjet që pëson shoqëria.

**NENI 8**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve, ndërmjet bashkëshorteve si dhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve.

**NENI 9**

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen të tretëve me miratim të Ortakut të Vetëm. Po kështu mund të përfshihet në shitblerje aksionesh me shoqëri të tjera duke u kthyer në filjale, shoqëri kontrolluese ose e kontrolluar nga një shoqëri tjetër.

**NENI 10**


Në çdo rast, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar, duhet të vërtetohet me një akt noterial.

**MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOMPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQËRISË.****NENI 11**

Të gjitha vendimet e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm duke u bazuar në dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin " Për shoqëritë tregëtare", në lidhje me marrjen e vendimeve.

AI VENDOS VËTË KRYESISHT PËR KËTO ÇËSHTJE:

- a) Merr vendime për ndryshimin e formës, emërimit, selisë, kapitalit, veprimtarisë së shoqërisë, ndryshim në zotërimin e kuotave të kapitalit të shoqërisë, pranim të ortakëve, pjesmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera dhe anasjelltas
- b) Miraton raportet financiare e bilancin vjetor, vendos për përdorimin e fitimit, organizimin e shoqërisë dhe për prishjen e saj.
- c) Emëron dhe shkarkon administratorin, likuidatorin, ekspertet kontabël si dhe drejton veprimtaritë e rëndësishme të shoqërisë.
- d) Emëron dhe shkarkon drejtuesin teknik të shoqërisë.



Marrja e vendimeve realizohet me iniciativën e Ortakut të Vetëm ose me kërkesë të administratorit, të ekspertit kontabël, të cilët në këtë rast duhet t'i njoftojnë Ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 ditë përpara takimit.

#### NENI 12

Shoqëria administrohet nga Ortaku i Vetëm ose një person tjetër i emëruar në këtë detyrë. Administratori i Parë i Shoqërisë emërohet z. PAIAM PEYMAN. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer veprimet e administratorit, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet kompetencave të përcaktuara në këtë statut. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Kohëzgjatja e mandatit të administratorit është pesë vjet nga data 13.01.2021.

#### NENI 13

Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 14

Disa nga kompetencat që i jepen administratorit janë:

- a) Të sigurojë drejtimin e mirë të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.
- b) Të administrojë pasuritë e shoqërisë.
- c) Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë.
- d) Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me organet e institucionet shtetërore, para organeve gjyqësore vetë ose duke autorizuar persona të tjerë kompetent.
- e) Të kryej veprime juridike në emër e për llogari të shoqërisë me të tretët si: të lidh kontrata, të kryej veprime bankare të ndryshme si çelje llogarish, marrje kredie, transferta etj.


#### NENI 15

Kontrolli i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

### VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE

#### NENI 16

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht nga kjo, viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit të shoqërisë si sh.p.k.



**NENI 17**

Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga administratori dhe eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetëm, brenda nje afati prej 6- muaj nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 18**

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda dates 31 Mars të vitit pasardhës.

**NENI 19**

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë, mbasi të jenë zbritur të gjitha shpenzimet e kryera, detyrimet fiskale, rezerva e domosdoshme etj., i shpërndahen Ortakut ose me vendim të tij mund të perdoren për investime, nxitjen e veprimtarisë tregtare, reklama dhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm dhe që i shërbejnë shoqërisë.

**NENI 20**

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirisht të fitimit dhe disponimit të pasurisë së saj në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që kryen.

**NENI 21**

Detyrimet që lindim gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, ajo i mbulon nga fondi rezervave ose nga shumatat suplementare.

**NENI 22**


Shoqëria gëzon të gjitha të drejtat, për mbrojtjen e pasurisë së saj, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**PUNËSIMI NË SHOQËRI****NENI 23**

Mardhëniet juridike ndërmjet shoqërisë dhe personave që punësohen do të rregullohen ndërmjet kontratave të punës bazuar në Kodin e Punës dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

**NENI 24**

Shoqëria merr përsipër, të shlyej rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

**PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDIMI**

## NENI 25

Shoqëria prishet përpara kohe kur:

- a) Rezultati ekonomik i aktivitetit të saj për disa vite radhas është me humbje.
- b) Për shkaqe të pa parashikuara shprehimisht në ligj.
- c) Në çdo rast tjetër me vendim të ortakut të vetëm.

## NENI 26

Shoqëria mund të shpallet në likuidim me vendim të ortakut të vetëm të saj ose nëpërmjet një vendimi nga gjykata në bazë të ligjit. Ajo hyn në procesin e likuidimit që në momentin e marrjes së vendimit. Për realizimin e këtij procesi Ortaku ose Gjykata emërojnë një ose më shumë likuidatore, të cilët përgatisin dhe paraqesin raportin përmbylles të aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë dhe bilancin përkatës.

**KUSHTE TË TJERA**

## NENI 27

Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm evidentohen në një libër të veçantë, i cili administrohet në selinë e shoqërisë.

## NENI 28

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organ kompetent për zgjidhje të tyre është Gjykata e Rrethit ku ka selinë shoqëria, referuar legjislacionit shqiptar në fuqi.

PËR SHOQËRINË "ORGANIMIC" Sh.p.k.

ORTAKU I VETËM

SHEYDA DO'A PEYMAN

